

KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH

Sot, me datë 29.04.2024, ne Tirane, palet e meposhtme u mblodhen per te lidhur kete Kontrate Shitblerje Kuotash (ketu e me poshte referuar si "Kontrata"), me kushtet si me poshte vijon:

SHITESI:

Shoqëria "AUTO MASTER" sh.a, me NUIS K71618004V, me adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 4, Godina Nr. 115, Mëzes, Tirane, përfaqësuar nga Administratori i saj Z.Eno Zeneli.
(ketu e me poshte referuar si "Shitësi")

BLERESI:

Shoqëria "GLOBAL AUTO ALBANIA" sh.p.k, me NUIS K81315016V, zyra e regjistruar e se ciles ndodhet ne Tirane, Kashar Mëzez, Rruga Dytesore, Tirane-Durres, Km. 4, Godina Nr. 115, Kati 0 dhe Kati 1, Lagjja Mezez, perfaqesuar nga Administratori i saj, Z.Sokol Barhani.
(ketu e me poshte referuar si "Bleresi")

(ketu e me poshte bashkerisht te referuara si "Palet" dhe vec e vec si "Pala")

Deklarime paraprake:

- Shitesi eshte ortak me pjesemarrje prej 100% (njqind perqind) ne shoqerine T-Rent shpk, me NUIS M41423009K (ketej e tutje referuar si "Shoqëria").
- Shitesi deshiron t'i shesë 100% (njqind perqind) të pjesëmarrjes së tij në kapitalin e shoqërisë (me tej "Kuota ne Shitje") Bleresit, ndersa Bleresi deshiron t'i blejë Kuotën ne Shitje sipas çmimit te percaktuar ne këtë Kontrate.

Palet, mbi bazen e deklarimeve paraprake te mesiperme, njohin dhe deklarojne si me poshte vijon:

1. OBJEKTI

- Objekti i kesaj kontrate eshte shitja e "Kuotës ne Shitje" te zoteruar nga Shitesi dhe blerja e saj nga Bleresi.
- Si rezultat i shitjes se lartpermendur ortaku i shoqërisë bëhet si me poshtë vijon:
 - Bleresi Shoqëria "GLOBAL AUTO ALBANIA" sh.p.k, ortak i vetem me pjesemarrje prej 100% (njqind perqind) ne kapitalin e shoqerise.

2. ÇMIMI I SHITJES

2.1 Përkundrejt kalimit te pronësisë se Kuotës ne Shitje sipas përcaktimeve me sipër, Bleresi i paguan Shitesit çmimin perkates sipas pjeses se kapitalit qe ai blen ne shoqeri, perkatesisht çmimin prej 100,000 (njqind mije) lekë (ketu e me poshte referuar si "Çmimi i Shitjes").

3. TRANSFERIMI I PRONËSISË MBI KUOTEN NE SHITJE

3.1. Me ane te kesaj kontrate, ne datën e nënshkrimit Shitesi i transferon Bleresit pronësinë mbi kuotën në Shitje sipas Nenit 1 me lart.

3.2 Blerësi duke nënshkruar këtë Kontratë dhe duke marrë në zotërim Kuotën në Shitje sipas pjesëve përkatëse, është dakord dhe pranon të gjithë të drejtat, kufizimet, deklaratat, rregullat e procedurat e përcaktuara në Statutin e Shoqërisë në të cilën ai behet ortak i vetëm dhe me të cilat deklaron se është njohur.

4. TE TJERA

4.1. Palet pranojnë që cdo deklaratë, dorezim apo garanci e Paleve, sic parashikohet në këtë kontratë, është e vërtetë dhe e saktë.

4.2. Kjo kontratë rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

4.3. Palet bien dakord që cdo mosmarreveshje që lind në lidhje me vlefshmerinë, interpretimin apo zbatimin e kësaj kontrate të zgjidhet nga Gjykata e Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

BAZA LIGJORE

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
Ligji 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata e Shitblerjes së Kuotave hartohet në 2 (dy) kopje, nga një për secilën palë, dhe firmoset dhe vulloset rregullisht nga Palet si më poshtë.


PALET KONTRAKTUESE

Për Shitesin
AUTO MASTER sha
Administratori
Z. Eno Zeneli



The image shows a handwritten signature in blue ink over a horizontal line. Below the signature is a blue circular stamp with the text "AUTO MASTER" in the center and "TIRANE-ALBANIA" around the bottom edge.

Për Blerësin
GLOBAL AUTO ALBANIA shpk
Administratori
Z. Sokol Barhani



The image shows a handwritten signature in blue ink over a horizontal line. Below the signature is a red circular stamp with the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISE" at the top, "GLOBAL AUTO ALBANIA" in the middle, "Shpk" in the center, and "TIRANE" at the bottom.